



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë ____/____/2026

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E LLOJIT TË
KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE, OFRIMIN DHE PËRFUNDIMIN E
SHËRBIMIT, FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT SHUMËDISIPLINAR DHE PËR
VLERËSIMIN, PROCEDURËN DHE VENDIMMARRJEN PËR VENDOSJEN E
FËMIJËS NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 5, 12, pika 7, dhe 16, pika 3, të ligjit nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky vendim përcakton:

- a) rregullat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ në familje;
- b) kriteret, procedurat dhe standardet bazë për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje;
- c) organizimin dhe funksionimin e komisionit shumëdisiplinar;
- ç) procedurat për vlerësimin, planifikimin, vendimmarrjen, monitorimin dhe përfundimin e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje;
- d) kriteret për identifikimin, vlerësimin, trajnimin, miratimin dhe regjistrimin e familjeve kujdestare;
- dh) mekanizmat e koordinimit ndërinstytucional ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel qendror e vendor.

**Neni 2
Qëllimi**

Ky vendim synon të garantojë një proces të standardizuar, transparent, të koordinuar dhe të bazuar në interesin më të lartë të fëmijës për ofrimin e kujdesit alternativ në familje, duke promovuar rritjen e fëmijës në mjedis familjar të shëndetshëm dhe mbështetjen e riintegritit familjar, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 3 Parimet

Lloji i kujdesit alternativ në familje, ofrimi dhe përfundimi i shërbimit të kujdesit alternativ në familje bazohet në parimet themelore që udhëheqin kujdesin alternativ në familje, e veçanërisht parimet e interesit më të lartë të fëmijës, parandalimit të ndarjes nga familja biologjike/aktuale, nevoja dhe përshtatshmëria, pjesëmarrja aktive e fëmijëve në vendosjen në kujdes alternativ në familje, barazia dhe mosdiskriminimi, qëndrueshmëria e marrëdhënieve shoqërore dhe familjare dhe ruajtja e identitetit.

KREU II LLOJET E KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 4 Format e kujdesit alternativ në familje

Kujdesi alternativ në familje ofrohet në dy format kryesore të mëposhtme:

- a) kujdes alternativ profesional në familje
- b) kujdes alternativ vullnetar në familje.

Neni 5 Kujdesi alternativ profesional në familje

1. Kujdesi alternativ profesional ofrohet nga familje kujdestare profesioniste të trajnuara, të vlerësuara, të miratuara dhe të regjistruara sipas këtij vendimi.
2. Kujdesi alternativ profesional përfshin këto tipologji:
 - a) kujdesin alternativ emergjent;
 - b) kujdesin alternativ afatshkurtër;
 - c) kujdesin alternativ afatgjatë, ose të përhershëm deri në moshën madhore kur rikthimi në familjen biologjike ose birësimi nuk janë të mundur;
 - ç) kujdesin alternativ të specializuar për fëmijët me nevoja komplekse, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, me trauma, me histori abuzimi, neglizhimi ose me nevoja të larta psikosociale;
 - d) kujdesin alternativ për vajza nëna me fëmijë, ose vajza shtatzëna, kur kjo masë vlerësohet si më e përshtatshme në interesin më të lartë të nënës dhe fëmijës.

Neni 6 Kujdesi alternativ vullnetar në familje

Kujdesi alternativ vullnetar mund të ofrohet nga familje të vlerësuara dhe të miratuara si familje kujdestare sipas legjislacionit në fuqi, si vijon:

- a) familje të të afërmeve të fëmijës, si gjyshi, gjyshja, motra ose vëllai në moshë madhore, ungji, emta, nipi apo mbesa, të të afërmeve të tjerë me lidhje familjare me fëmijën;

- b) familje të të afërme të fëmijës, të rrethit të ngushtë miqësor të familjes të njohur nga fëmija;
- c) familje që nuk kanë lidhje familjare me fëmijën, që shfaqin vullnetin e tyre për të ofruar vullnetarisht shërbimin e kujdesit alternativ.

Neni 7

Kriteret për përcaktimin e llojit të kujdesit

Në përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ merren parasysh:

- a) niveli i rrezikut dhe urgjenca e mbrojtjes së fëmijës;
- b) moshë e fëmijës;
- c) gjendja shëndetësore, emocionale, psikologjike dhe zhvillimore e fëmijës;
- ç) prania e aftësisë së kufizuar ose nevojave komplekse;
- d) historia e traumës, abuzimit, neglizhimit ose shfrytëzimit;
- dh) marrëdhëniet e fëmijës me familjen biologjike dhe rrjetin e tij social;
- e) kohëzgjatja e pritshme e vendosjes;
- ë) disponueshmëria dhe profili i familjes kujdestare;
- f) mendimi i fëmijës, në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj.

KREU II

KRITERET, VLERËSIMI DHE REGJISTRIMI I FAMILJEVE KUJDESTARE

Neni 8

Kriteret e përgjithshme për familjet kujdestare

1. Familjet kujdestare duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme, të cilat vlerësohen në mënyrë të dokumentuar nga strukturat përgjegjëse:
 - a) Kapaciteti ligjor dhe integriteti:
 - i. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
 - ii. të jenë jo më pak se në moshë madhore dhe jo më shumë se në moshë pensioni sipas legjislacionit në fuqi në vend, me përjashtim të rasteve të kujdesit alternativ vullnetar në familje nga të afërm;
 - iii. prindi aplikues të ketë shtetësi shqiptare ose leje të rregullt qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe vendbanim të përhershëm dhe jeton në Republikën e Shqipërisë;
 - iv. të mos jenë në proces hetimi apo ndjekjeje penale;
 - v. të mos kenë asnjë anëtar të familjes të dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë;
 - vi. të mos kenë asnjë anëtar të familjes që rezulton i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, sipas ligjit nr. 62/2022 “Për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale
 - vii. të mos jenë dënuar me vendim penal të formës së prerë për vepra penale kundër fëmijëve, kundër personit, kundër familjes, kundër moralit, për dhunë në familje, trafikim, narkotikë, si dhe për çdo vepër tjetër penale të rëndë që cenon sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës;

- viii. të mos jenë të regjistruar në regjistrat përkatës për vepra penale që lidhen me dhunën, abuzimin apo shfrytëzimin.
 - ix. Familja nuk është përjashtuar më parë nga ofrimi i kujdesit alternativ në familje;
 - x. ka pëlqimin me shkrim të të gjithë anëtarëve në moshë madhore të familjes, sipas certifikatës familjare për të kryer kujdestarinë.
- b) Të kenë gjendje të qëndrueshme shëndetësore:
- i. të jenë në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe mendore, e vërtetuar me raport mjekësor;
 - ii. të mos kenë kushte shëndetësore që pengojnë përmbushjen e përgjegjësisë të kujdesit ndaj fëmijës;
 - iii. anëtarët e familjes janë në gjendje shëndetësore fizike ose mendore, që nuk rrezikojnë shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.
- c) Kushtet e banimit dhe mjetet e jetesës:
- i. të disponojnë ambiente të sigurta, të shëndetshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e fëmijës;
 - ii. të sigurojnë hapësirë të mjaftueshme jetese dhe kushte higjieno-sanitare sipas standardeve në fuqi;
 - iii. të garantojnë akses në shërbime bazë (arsim, shëndetësi, transport);
 - iv. të sigurojnë mjete të mjaftueshme të jetesës;
 - v. të ketë ardhura të qëndrueshme.
- d) Qëndrueshmëri familjare dhe shoqërore:
- i. të kenë marrëdhënie të qëndrueshme familjare dhe mjedis mbështetës për fëmijën;
 - ii. të mos jenë të përfshirë në situata të përsëritura konflikti, dhune apo paqëndrueshmërie sociale;
 - iii. të kenë një rrjet minimal mbështetës (familjar apo komunitar).
- d) Kapacitetet prindërore dhe motivimi:
- i. të demonstrojnë aftësi për kujdes, edukim dhe mbështetje emocionale të fëmijës;
 - ii. të kenë motivim të qartë dhe realist për ofrimin e kujdesit alternativ në familje;
 - iii. të tregojnë aftësi për të respektuar individualitetin dhe nevojat specifike të fëmijës.
- dh) Bashkëpunimi me institucionet:
- i. të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës;
 - ii. të pranojnë dhe zbatojnë planin individual të kujdesit alternativ në familje dhe rekomandimet profesionale;
 - iii. të respektojnë detyrimin për monitorimin, vlerësimin periodik, raportim dhe transparencë.
- e) Të kryejnë trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm sipas ligjit dhe këtij vendimi.
2. Për familjet kujdestare profesionale, përveç kriterëve të mësipërme, kërkohen edhe kriteret shtesë lidhur me kapacitetin për të punuar me fëmijë me nevoja komplekse dhe gatishmërinë për përfshirje intensive dhe të vazhdueshme në shërbim.
 3. Kriteret e përcaktuara në këtë nen janë pjesë e standardeve në fuqi të ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

Neni 9

Ndihma aktive

Struktura përgjegjëse e shërbimeve shoqërore në bashki ofron ndihmë aktive subjekteve të interesuara për të ofruar shërbimin e kujdesit alternativ në familje, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative në fuqi.

Neni 10

Aplikimi dhe vlerësimi paraprak

1. Subjekti i interesuar për të ofruar shërbimin e kujdesit alternativ në familje paraqet kërkesë nëpërmjet portalit “e-Albania”.
2. Familjet alikuese shprehin interesin e tyre për të ofruar shërbimin e kujdesit alternativ në familje, sipas formularit të aplikimit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki kryen verifikimin paraprak administrativ të dokumentacionit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së aplikimit në e-Albania. Në rast se vërehen mangësi në aplikim, dokumentacioni rezulton i paplotë ose i pasaktë, aplikuesi njoftohet menjëherë për plotësimin e tij.
4. Aplikuesi njoftohet me shkrim për kalimin në fazën e vlerësimit të aplikimit ose për mospranimin e aplikimit, të arsyetuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga përfundimi i verifikimit paraprak.

Neni 11

Vlerësimi i familjeve kujdestare

1. Vlerësimi i familjeve kujdestare është vlerësimi i të gjitha kriterëve të parashikuara në nenin 8 të këtij vendimi dhe përfshin, pa u kufizuar në, sa vijon:
 - a) intervistën individuale dhe familjare me të gjithë anëtarët e familjes sipas certifikatës familjare;
 - b) vizitat në banesë për vlerësimin e kushteve të jetesës;
 - c) vlerësimin social dhe psikologjik të aplikuesit dhe anëtarëve të familjes;
 - ç) raportin mjekësor të aftësisë për punë për prindin aplikues dhe të gjithë anëtarët e familjes;
 - d) dëshminë e gjendjes gjyqësore, vërtetim që nuk ka pasur dhe nuk ka të regjistruar asnjë procedim penal;
 - dh) referenca nga dy familje të komunitetit ku jeton;
 - e) intervistën me ndërlidhësin komunitar, administratorin social, kryeplakun, inspektorin e zonës të Policisë së Shtetit;
 - ë) informacion nga Regjistri Kombëtar i të Dënuarve për Krime Seksuale, sipas legjislacionit në fuqi për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale;
 - f) kushtet e banimit të familjes aplikuese, përmes vërtetimit që ka banesë nga e-Albania ose kontratën e qirasë në të cilën të përcaktohen edhe kushtet e banesës;
 - g) verifikim që nuk është përjashtuar më parë nga ofrimi i kujdesit alternativ në familje;
 - gj) pëlqimi me shkrim të të gjithë anëtarëve në moshë madhore të familjes, sipas

- certifikatës familjare, për të ofruar shërbimin e kujdestarisë alternative në familje;
 - h) verifikim për aftësinë për të punuar me fëmijë me nevoja komplekse, përfshirë trauma, aftësi të kufizuara apo sjellje sfiduese;
 - i) përvojë të mëparshme me kujdestarinë alternative apo shërbime sociale, nëse ka;
 - j) gatishmërinë për angazhim të plotë në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë alternative në familje.
2. Vlerësimi përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të verifikimit paraprak të aplikimit, sipas këtij vendimi. Në raste të veçanta, me vendim të argumentuar, ky afat mund të zgjatet edhe me 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.
 3. Strukturat kompetente të bashkisë njoftojnë aplikuesit për dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqitet prej tyre me qëllim shqyrtimin e aplikimit. Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit, familjet aplikuese janë të detyruara të paraqesin vetëm ato dokumente të cilat shërbimet sociale në bashki e kanë të pamundur t'i sigurojnë vetë si pjesë të dosjes.
 4. Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në raportin social dhe psikologjik të strukturuar, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe përmbajnë rekomandimin për përzgjedhjen ose jo të familjes si familje kujdestare, si dhe llojin e kujdesit alternativ në familje për të cilin ajo është e përshtatshme.
 5. Dosja e përgatitur sipas këtij neni, plotësohet me të gjithë dokumentacionin dhe vlerësimet e nevojshme me qëllim që të paraqitet para Komisionit shumëdisiplinar për vendimmarrje.

Neni 12

Trajnimi i familjeve aplikuese për të ofruar shërbimin e kujdesit alternativ në familje

1. Familjet që vlerësohen pozitivisht ndjekin programin unik bazë të detyrueshëm të trajnimit para marrjes së vendimit për t'u përfshirë në listën e familjeve që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ në familje. Programi dhe modulet e trajnimit hartohen nga Shërbimi Social Shtetëror dhe certifikohen nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Programi unik bazë i trajnimit, për familjet kujdestare vullnetare dhe profesionale, përfshin njohuri dhe aftësi mbi:
 - a) zhvillimin e fëmijës dhe nevojat sipas grupmoshave;
 - b) mbrojtjen e fëmijëve dhe kuadrin ligjor për kujdesin alternativ në familje;
 - c) rolin dhe përgjegjësitë e familjes kujdestare;
 - ç) disiplinimin pozitiv dhe mbrojtjen nga çdo formë dhune;
 - d) komunikimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve me fëmijën;
 - dh) bashkëpunimin me strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe familjen biologjike.
3. Për familjet kujdestare profesionale programi i trajnimit përfshin edhe module të specializuara për:
 - a) traumën dhe sjelljet sfiduese;
 - b) përkujdesjen për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja komplekse;
 - c) menaxhimin e situatave emergjente;
 - ç) komunikimin dhe ndërmjetësimin me familjen biologjike;
 - d) etikën profesionale dhe standardet e kujdesit alternativ në familje;
 - dh) bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe menaxhimin e rasteve;

- e) mbështetjen për zhvillimin social, emocional, arsimor dhe kulturor të fëmijës.
4. Përfundimi me sukses i programit të trajnimit dokumentohet me certifikatë, e cila është kusht për regjistrimin e aplikuesve si familje kujdestare.
 5. Familjet kujdestare profesionale i nënshtrohen trajnimeve të vazhdueshme gjatë ofrimit të shërbimit.
 6. Strukturat e shërbimeve sociale në bashki, vetë, në bashkëpunim me, apo me mbështetjen e organizatave jofitimprurëse ose aktorëve të tjerë, planifikojnë dhe ofrojnë veprimtari të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të familjeve që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ në familje.

Neni 13

Miratimi dhe regjistrimi i familjeve kujdestare

1. Dosja e përgatitur për shqyrtimin e aplikimit i paraqitet Komisionit shumëdisiplinar menjëherë me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 10 të këtij vendimi.
2. Komisioni shumëdisiplinar shqyrton dosjen dhe merr vendim për pranimin ose refuzimin e familjes si familje kujdestare, ose për pushimin e shqyrtimit të rastit. Vendimi regjistrohet në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.
3. Familjet e miratuara përfshihen në listën e familjeve kujdestare pritëse, e cila organizohet sipas llojeve të kujdesit alternativ në familje në nivel bashkie dhe është pjesë e Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

KREU III

KOMISIONI SHUMËDISIPLINAR

Neni 14

Krijimi i Komisionit Shumëdisiplinar

Pranë çdo bashkie krijohet Komisioni Shumëdisiplinar për kujdesin alternativ në familje, si organ kolegjial vendimmarrës për shqyrtimin e aplikimeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

Neni 15

Përbërja

1. Komisioni shumëdisiplinar ngrihet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:
 - a) drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
 - b) drejtuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse (NJMF) për shërbimet shoqërore në bashki;
 - c) drejtuesi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit (punonjësi social) pranë bashkisë apo njësisë administrative;
 - ç) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit;

- d) juristi;
 - dh) psikologu;
 - e) specialisti për çështjet e arsimit;
 - ë) specialisti për çështjet e shëndetësisë;
 - f) përfaqësuesi në nivel vendor nga Policia e Shtetit.
2. Komisioni shumëdisiplinar ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Neni 16 **Kompetencat**

Komisioni ka këto kompetenca:

- a) shqyrton aplikimet e familjeve kujdestare dhe vlerësimet e kryera nga struktura e posaçme;
- b) vendos për miratimin e familjes kujdestare, refuzimin, pezullimin ose heqjen e të drejtës për të ofruar shërbimin e kujdesit alternativ në familje;
- c) shqyrton dosjet e rasteve të fëmijëve për të cilët propozohet vendosja në familje kujdestare;
- ç) përcakton llojin e kujdesit alternativ në familje më të përshtatshëm;
- d) propozon vendosjen e fëmijës në familje kujdestare;
- dh) shqyrton periodikisht ecurinë e vendosjes së fëmijës në familje kujdestare;
- e) rekomandon ndryshimin ose përfundimin e vendosjes së fëmijës në familje kujdestare, kur është e nevojshme.

Neni 17 **Funksionimi i Komisionit Shumëdisiplinar**

1. Komisioni shumëdisiplinar mblidhet jo më pak se një herë në 2 (dy) muaj, si dhe sa herë që paraqitet nevoja për shqyrtimin e rasteve konkrete.
2. Mbledhja e Komisionit shumëdisiplinar është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote. Vendimet e Komisionit shumëdisiplinar merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij me të drejtë vote.
3. Për çdo mbledhje të Komisionit shumëdisiplinar mbahet procesverbal, në të cilin pasqyrohen pjesëmarrja, çështjet e shqyrtuara, diskutimet kryesore, vendimmarrja dhe, sipas rastit, mendimet kundër.
4. Vendimet e Komisionit shumëdisiplinar hartohen sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Sipas natyrës së çështjes që shqyrtohet, në mbledhjet e Komisionit shumëdisiplinar mund të ftohen specialistë të tjerë nga institucione publike, organizata të shoqërisë civile ose ofrues të licencuar të shërbimeve, të cilët marrin pjesë pa të drejtë vote.
6. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki ushtron funksionet e sekretariatit teknik të Komisionit shumëdisiplinar dhe siguron përgatitjen e dokumentacionit, njoftimin e anëtarëve, mbajtjen e procesverbalit dhe administrimin e akteve të mbledhjes.

KREU IV
VLERËSIMI, PROCEDURA DHE VENDIMARRJA PËR VENDOSJEN E
FËMIJËS NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 18

Vlerësimi i rastit për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Vlerësimi i rastit për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje kryhet nga njësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijës, për kujdesin alternativ në familje dhe aktet nënligjore në fuqi për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje dhe kriteret, procedurat dhe instrumentet për vlerësimin dhe vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje.
2. Komisioni shumëdisiplinar shqyrton dosjen e rastit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e saj. Në rastet emergjente, shqyrtimi bëhet menjëherë, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga momenti i referimit.
3. Komisioni shumëdisiplinar vlerëson përputhshmërinë ndërmjet nevojave të fëmijës dhe profilit të familjes kujdestare të miratuar dhe të regjistruar në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, e cila ka përmbushur të gjitha procedurat e vlerësimit dhe trajnimit dhe është në pritje për vendosje.

Neni 19

Vendimi i Komisionit Shumëdisiplinar për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Vendimi i Komisionit shumëdisiplinar për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje përmban:
 - a) të dhënat identifikuese të fëmijës;
 - b) llojin e kujdesit alternativ të përcaktuar;
 - c) familjen kujdestare të përzgjedhur;
 - ç) arsyetimin e përzgjedhjes, duke përfshirë vlerësimin e përputhshmërisë ndërmjet nevojave të fëmijës dhe profilit të familjes kujdestare;
 - d) kohëzgjatjen e vendosjes së fëmijës në familje kujdestare.
2. Vendimi i Komisionit shumëdisiplinar i njoftohet familjes kujdestare të përzgjedhur, dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki si dhe strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki për ndjekjen e tij sipas nenit 20 të këtij vendimi.

Neni 20

Miratimi nga gjykata dhe vendosja në kujdes alternativ në familje

1. Vendosja e një fëmije në një familje kujdestare realizohet vetëm në rastet kur ndaj fëmijës është aplikuar masa e mbrojtjes për vendosje në kujdes alternativ në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

2. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki i paraqet gjykatës kompetente, brenda 5 (pesë) ditëve pune, së bashku me kërkesën për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes për vendosje të fëmijës në kujdes alternativ sipas legjisllacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, edhe vendimin e komisionit shumëdisiplinar dhe dokumentacionin mbështetës për familjen kujdestare të identifikuar si të përshtatshme me nevojat e fëmijës.
3. Gjykatës i paraqitet dosja e cila përfshin, të paktën:
 - a) vendimin e komisionit shumëdisiplinar për masën e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ;
 - b) vendimin e komisionit shumëdisiplinar për përzgjedhjen e familjes kujdestare në përputhje me nevojat e fëmijës;
 - c) planin individual i mbrojtjes sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve;
 - ç) çdo dokument tjetër mbështetës që vërteton nevojën për vendosje të fëmijës dhe përshtatshmërinë e familjes kujdestare.
4. Vendosja në familjen kujdestare realizohet pas vendimit të gjykatës. Në rastet emergjente, kur kërkohet ndërhyrje e menjëhershme për mbrojtjen e fëmijës, njësia për mbrojtjen e fëmijës mund të realizojë vendosjen e përkohshme në një familje kujdestare profesionale të regjistruar në listën e familjeve kujdestare pritëse, dhe i drejtohet menjëherë gjykatës për miratim. Vendosja e fëmijës në këtë rast është e përkohshme deri në vendimmarrjen e gjykatës.

Neni 21

Ndryshimi i vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ

1. Vendosja e fëmijës në kujdes alternativ mund të ndryshohet kur ndryshojnë nevojat e tij/saj shëndetësore, psikologjike, sociale, arsimore ose kur paraqiten rrethana të tjera që e bëjnë të nevojshëm ndryshimin, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.
2. Ndryshimi i vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ vendoset nga Komisioni shumëdisiplinar, pas vlerësimit të rastit nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimt në bashki.
3. Vendimi i Komisionit shqyrtohet nga gjykata. Ndryshimi i vendosjes së fëmijës realizohet vetëm pas miratimit të vendimit të gjykatës, sipas nenit 20 të këtij vendimi.

KREU V

KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I SHËRBIMIT TË KUJDESIT ALTERNATIV

Neni 22

Kohëzgjatja e kujdesit alternativ në familje

1. Kohëzgjatja e kujdesit alternativ në familje përcaktohet në përputhje me tipologjinë e shërbimit, nevojat individuale të fëmijës dhe interesin më të lartë të tij/saj.
2. Për kujdesin alternativ profesional në familje, kohëzgjatja e vendosjes është si më poshtë:
 - a) kujdesi alternativ emergjent ofrohet për një periudhë deri në 3 (tre) muaj, me qëllim garantimin e mbrojtjes së menjëhershme dhe stabilizimin e situatës së fëmijës;

- b) kujdesi alternativ afatshkurtër ofrohet për një periudhë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj, me qëllim përgatitjen për riintegrimin e fëmijës në familjen biologjike/aktuale ose përcaktimin e një zgjidhjeje tjetër të përshtatshme;
 - c) kujdesi alternativ afatgjatë ose i përhershëm ofrohet për periudha mbi 12 (dymbëdhjetë) muaj dhe mund të vijojë deri në moshën madhore të fëmijës, kur rikthimi në familjen biologjike ose birësimi nuk janë të mundur;
 - ç) kujdesi alternativ i specializuar ofrohet për aq kohë sa vlerësohet i nevojshëm për përmbushjen e nevojave komplekse të fëmijës dhe rishikohet periodikisht, të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj;
 - d) kujdesi alternativ për vajza nëna me fëmijë ose vajza shtatzëna ofrohet për një periudhë deri në 24 (njëzet e katër) muaj, me mundësi rishikimi dhe zgjatjeje sipas nevojave të rastit dhe interesit më të lartë të nënës dhe fëmijës;
 - dh) kujdesi alternativ vullnetar në familje ofrohet për periudhën e përcaktuar në vendimin përkatës të vendosjes dhe rishikohet periodikisht, në përputhje me planin individual të kujdesit dhe situatën e fëmijës.
3. Afatet e përcaktuara në këtë nen mund të rishikohen ose zgjaten në raste të veçanta, bazuar në vlerësimin periodik të situatës së fëmijës, nevojat për mbrojtje dhe interesin më të lartë të tij/saj. Rezultatet e rishikimit periodik dokumentohen në dosjen individuale të fëmijës, në PIM, në PIK dhe në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

Neni 23

Tërheqja e familjes kujdestare nga shërbimi i kujdesit alternativ

1. Familja kujdestare ka të drejtë të tërhiqet nga ofrimi i kujdesit alternativ vetëm për arsye objektive, duke njoftuar me shkrim njësinë për mbrojtjen e fëmijës dhe strukturën përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, menjëherë me lindjen e shkakut të tërheqjes.
2. Tërheqja e familjes kujdestare nga shërbimi i kujdesit alternativ nuk duhet të cenojë interesin më të lartë të fëmijës dhe vlerësohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. Vendimi për pranimin e tërheqjes së familjes kujdestare nga shërbimi i kujdesit alternativ miratohet nga Komisionin shumëdisiplinar dhe pasqyrohet në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.
3. Në rastet kur tërheqja kërkohet gjatë kohës që fëmija është i vendosur në familje, njësia për mbrojtjen e fëmijës merr masa të menjëhershme për:
 - a) vlerësimin e situatës së fëmijës;
 - b) garantimin e vijimësisë së kujdesit;
 - c) identifikimin e një zgjidhjeje alternative të përshtatshme.

Neni 24

Përfundimi i kujdesit alternativ në familje

1. Kujdesi alternativ në familje përfundon kur:
 - a) përfundon afati i përcaktuar në vendimin për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ;

- b) fëmija rikthehet në familjen biologjike ose aktuale, kur kjo është në interesin më të lartë të tij/saj;
 - c) vendoset një formë tjetër më e përshtatshme e kujdesit alternativ;
 - ç) fëmija mbush moshën madhore, përveç rasteve kur legjislacioni në fuqi parashikon vijimin e mbështetjes;
 - d) gjykata vendos ndryshimin ose përfundimin e masës së mbrojtjes;
 - dh) familja kujdestare tërhiqet nga ofrimi i shërbimit dhe kjo tërheqje miratohet sipas procedurave të këtij vendimi;
 - e) konstatohet se vijimi i vendosjes nuk është më në interesin më të lartë të fëmijës.
2. Kujdesi alternativ në familje mund të ndërpritet menjëherë kur familja kujdestare:
- a) neglizhon ose nuk plotëson nevojat bazë të fëmijës;
 - b) ushtron dhunë, abuzim, ndëshkim fizik, presion psikologjik ose çdo formë tjetër keqtrajtimi ndaj fëmijës;
 - c) nuk respekton planin individual të kujdesit dhe masat e përcaktuara nga strukturat përgjegjëse;
 - ç) pengon kontaktet e fëmijës me familjen biologjike/aktuale, kur këto janë të lejuara dhe në interesin më të lartë të fëmijës;
 - d) cenon privatësinë, dinjitetin ose të drejtat e fëmijës;
 - dh) refuzon bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe menaxhimin e rastit;
 - e) nuk njofton situata që cenojnë sigurinë ose mirëqenien e fëmijës;
 - ë) përdor fëmijën për përfitime ekonomike, punë të papërshtatshme ose forma të tjera shfrytëzimi;
 - f) paraqet të dhëna ose dokumentacion të rremë;
 - g) shkel detyrimet ligjore dhe etike në ofrimin e kujdesit alternativ në familje.
3. Në rastet e përfundimit, ndërprerjes ose ndryshimit të kujdesit alternativ, njësia për mbrojtjen e fëmijës dhe strukturat përgjegjëse marrin menjëherë masa për vlerësimin e situatës së fëmijës, garantimin e sigurisë dhe vijimësisë së kujdesit, si dhe identifikimin e një alternative tjetër të përshtatshme kujdesi.
4. Çdo vendimmarrje dhe masë e marrë sipas këtij neni dokumentohet në dosjen individuale të fëmijës dhe në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25 Raportimi

Bashkitë raportojnë periodikisht pranë Shërbimit Social Shtetëror, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes, funksionimin e familjeve kujdestare, ecurinë e vendimmarrjeve të komisionit shumëdisiplinar dhe funksionimin e mekanizmave të kujdesit alternativ në familje.

Neni 26
Dispozita kalimtare

Familjet kujdestare të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi i nënshtrohen rishikimit të profilit dhe dokumentacionit sipas dispozitave të këtij vendimi, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDIRAMA

SHTOJCA NR. 1

FORMULAR APLIKIMI PËR FAMILJE KUJDESTARE

I. TË DHËNAT E APLIKUESIT/VE

1. Emri, mbiemri: _____
2. Datëlindja: _____
3. Nr. personal / ID: _____
4. Gjinia: M _____ F _____
5. Adresa e vendbanimit: _____
6. Adresa e vendqendrimit, kur është e ndryshme nga adresa e vendbanimit:

7. Njësia administrative / Bashkia: _____
8. Numri i telefonit: _____
9. Adresa e e-mail-it: _____
10. Statusi familjar/gjendja civile: _____
11. Statusi:
 shtetas shqiptar
 leje të rregullt qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.
12. Vendqendrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë
13. Profesionit / punësimi aktual: _____
14. Të ardhurat mujore të familjes: _____

II. TË DHËNAT PËR PËRBËRJEN FAMILJARE

1. Emri i bashkëshortit/es ose partnerit/es: _____
2. Numri i anëtarëve të familjes: _____
3. Numri i fëmijëve biologjikë: _____
4. Moshë e fëmijëve biologjikë: _____
5. A jetojnë persona të tjerë në banesë?
 Po
 Jo

Nëse po, specifikoni: _____

III. LLOJI I KUJDESIT PËR TË CILIN APLIKOHET

Aplikoj për:

- Kujdes alternativ vullnetar
- Kujdes alternativ profesional

Nëse aplikimi është për ofrimin e kujdesit alternativ profesional në familje, profili i preferuar është:

- kujdesin alternativ emergjent
- kujdesin alternativ afatshkurtër
- kujdesin alternativ afatgjatë / i përhershëm
- kujdesin alternativ i specializuar për fëmijë me nevoja komplekse
- kujdesin alternativ për vajza nëna me fëmijë ose vajza shtatzëna

IV. MOTIVIMI PËR TË OFRUAR KUJDES ALTERNATIV

Ju lutem përshkruani arsyet pse dëshironi të bëheni familje kujdestare:

V. AFTËSITË DHE PËRVOJA

1. A keni përvojë në kujdesin ndaj fëmijëve?

- Po
- Jo

Nëse po, shpjegoni shkurtimisht:

2. A keni ndjekur trajnime ose kualifikime në fushën sociale, arsimore, shëndetësore ose psikologjike?

- Po
- Jo

Nëse po, specifikoni:

3. A jeni i/e gatshëm/me të ndiqni trajnimet e detyrueshme dhe supervizimin profesional?

- Po
- Jo

VI. GJENDJA SHËNDETËSORE

1. A vuani nga ndonjë gjendje shëndetësore fizike apo mendore, që mund të ndikojë në përmbushjen e përgjegjësive të kujdesit alternativ në familje?

Po

Jo

Nëse po, specifikoni: _____

VI. GJENDJA LIGJORE

1. A jeni apo keni qenë i dënuar për një vepër penale: Po Jo

2. A është regjistruar ndonjëherë një procedim penal ndaj jush? Po Jo

3. A jeni aktualisht në proces hetimi apo gjykimi për një vepër penale Po Jo

4. A rezultoni në listën e Regjistrimit Kombëtar të Dënuarve për Krime Seksuale Po
 Jo

A jepni pëlqimin për verifikimin e gjendjes penale sipas legjislacionit në fuqi?

Po Jo

VII. KUSHTET E BANIMIT

1. Lloji i banesës:

Apartament

Shtëpi individuale

Tjetër: _____

2. Statusi i banesës:

Në pronësi

Me qira

Në përdorim tjetër ligjor

3. Numri i dhomave: _____

4. A ka hapësirë të përshtatshme për fëmijën?

Po

Jo

5. A janë kushtet e banimit të sigurt dhe të përshtatshme për mirërritjen e fëmijës?

Po

Jo

Përshkrim i shkurtër i banesës:

VIII. DOKUMENTET SHOQËRUESE FILLESTARE

Aplikuesi i bashkëlidh këtë aplikimi dokumentet si vijon:

- Kopje e dokumentit të identifikimit
- Certifikatë familjare
- Vërtetim banimi / vendqendrimi

IX. DEKLARATË E SHPREHJES SË INTERESIT DHE SAKTËSISË SË TË DHËNAVE

Unë deklaroj se përmes këtij aplikimi shpreh interesin e lirë të ofroj shërbimin e kujdesit alternativ në familje sipas legjislacionit në fuqi.

Unë deklaroj se informacioni i dhënë në këtë formular është i saktë dhe i plotë, si dhe pranoj që institucionet përgjegjëse të kryejnë verifikimet e nevojshme për vlerësimin e aplikimit tim.

Emri dhe mbiemri: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

SHTOJCA NR. 2
MODELI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT SOCIAL DHE PSIKOLOGJIK TË
FAMILJES KUJDESTARE
(Plotësohet nga punonjësi social / ekipi i vlerësimit)

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. Emri i familjes aplikante: _____
 2. Data e vlerësimit: _____
 3. Institucioni përgjegjës: _____
 4. Punonjësi social: _____
 5. Specialistë të tjerë të përfshirë në vlerësim: _____
 6. Numri i anëtarëve të familjes sipas certifikatës familjare: _____
-

Data e vizitës/ve në banesë: _____

II. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Metodat e përdorura:

- Intervistë me aplikuesit
- Intervistë me anëtarë të tjerë të familjes
- Vizitë në banesë
- Verifikim dokumentacioni
- Konsultim me institucione të tjera
- Vlerësim psikologjik
- Referenca komunitare
- Tjetër: _____

III. VLERËSIMI I FAMILJES

1. Gjendja socio-ekonomike

Të dhëna mbi:

- punësimin;
- burimet e të ardhurave;
- stabilitetin financiar;
- kushtet e banimit.

Përshkrimi:

2. Gjendja familjare dhe marrëdhëniet

Të dhëna mbi:

- përbërjen familjare;
- stabilitetin e marrëdhënieve familjare;
- aftësinë për kujdes prindëror;
- mbështetjen nga rrjeti familjar dhe komunitar.

Përshkrimi:

3. Gjendja shëndetësore dhe psikologjike

Të dhëna mbi:

- gjendjen fizike;
- gjendjen emocionale;
- aftësinë për përballimin e përgjegjësisë;
- faktorët e riskut ose kufizimeve të mundshme.

Përshkrimi:

4. Motivimi për kujdes alternativ

Të dhëna mbi:

- arsyet e aplikimit;
- pritshmëritë e familjes;
- gatishmërinë për bashkëpunim me institucionet;
- gatishmërinë për trajnim dhe supervizim.
- gatishmërinë për angazhim të plotë në ofrimin e shërbimit;
- përvojën e mëparshme me kujdestarinë alternative apo shërbime sociale, nëse ka.

Përshkrimi:

5. Aftësitë prindërore dhe kapaciteti perkujdesës

Vlerësohen:

- aftësia për të krijuar ambient të sigurt dhe mbrojtës;
- aftësia për të përmbushur nevojat emocionale, arsimore, shëndetësore dhe sociale të fëmijës;
- aftësia për të menaxhuar sjellje sfiduese;
- aftësia për të mbështetur identitetin, lidhjet familjare dhe diversitetin kulturor të fëmijës;
- aftësia për të punuar me fëmijë me trauma, aftësi të kufizuara ose nevoja komplekse.

Përshkrimi:

6. Vlerësimi i kushteve të banimit

Vlerësohen:

- siguria fizike e ambientit;
- higjiena;
- hapësira e mjaftueshme;
- kushtet për privatësi dhe mirëritje.

Përshkrimi:

7. Verifikimet ligjore dhe administrative

Dokumenti / Verifikimi	Po	Jo	Komente
Raporti mjekësor i aftësisë për punë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Dëshmi penaliteti	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Vërtetim për mungesë procedimi penal	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Verifikim në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Verifikim që nuk është përjashtuar më parë nga kujdestaria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Vërtetim banese / kontratë qiraje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

8. Referencat dhe konsultimet komunitare

Burimi i informacionit	I realizuar	Komente
Referenca nga familja 1	<input type="checkbox"/>	
Referenca nga familja 2	<input type="checkbox"/>	
Konsultim me administratorin social	<input type="checkbox"/>	
Konsultim me kryeplakun / ndërlidhësin komunitar	<input type="checkbox"/>	
Konsultim me policinë e zonës	<input type="checkbox"/>	

Komente:

9. Pëlqimi i anëtarëve madhorë të familjes

Është marrë pëlqimi me shkrim i të gjithë anëtarëve madhorë të familjes sipas certifikatës familjare.

Komente:

10. Vlerësimi i profilit të përshtatshëm të kujdesit

Familja vlerësohet si e përshtatshme për:

- Kujdes alternativ vullnetar
- Kujdes alternativ profesional emergjent
- Kujdes alternativ profesional afatshkurtër
- Kujdes alternativ profesional afatgjatë
- Kujdes alternativ profesional terapeutik / të specializuar

Kujdes për vajza nëna me fëmijë

Numri i rekomanduar i fëmijëve: _____

Grupmosha e rekomanduar: _____

Nevoja të veçanta që mund të përballohen: _____

IV. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Vlerësimi bazohet në analizën e integruar të elementeve sociale, psikologjike, familjare, ekonomike, ligjore dhe të kapaciteteve prindërore të familjes aplikuese.

Familja konsiderohet:

Miratimin e familjes si familje kujdestare

Refuzimin e aplikimit

Arsyetimi:

V. REKOMANDIMI

Punonjësi social rekomandon:

Miratimin e familjes si familje kujdestare

Refuzimin e aplikimit

Arsyetimi i rekomandimit:

Emri i punonjësit social: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Emri i psikologut:

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Emri i anëtarit tjetër të ekipit (nëse ka):

Data: _____

Nënshkrimi: _____

SHTOJCA NR. 3
MODELI I VENDIMIT TË KOMISIONIT SHUMËDISIPLINAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____

KOMISIONI SHUMËDISIPLINAR PËR KUJDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE

VENDIM

Nr. _____, datë ____ / ____ /20 ____

PËR

- MIRATIMIN E FAMILJES KUJDESTARE
- REFUZIMIN E APLIKIMIT
- VENDOSJEN E FËMIJËS NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE
- NDRYSHIMIN / PËRFUNDIMIN E VENDOSJES SË FËMIJËS NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE

Në mbështetje të ligjit nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", dhe të Vendimit nr. _____, datë ____ / ____ /2026, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat dhe procedurat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ në familje, ofrimin dhe përfundimin e shërbimit, funksionimin e komisionit shumëdisiplinar dhe për vlerësimin, procedurën dhe vendimmarrjen për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje" si dhe Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit të dosjes së përgatitur dhe shqyrtimit në mbledhjen e datës ____ / ____ / ____, Komisioni Shumëdisiplinar

VENDOSI:

I. TË DHËNAT E RASTIT / APLIKIMIT

1. Emri i fëmijës / familjes aplikante: _____ / _____
2. Data e lindjes / identifikimi: _____
3. Njësia referuese: _____
4. Data e referimit / aplikimit: _____
5. Dokumentacioni i shqyrtuar: _____

II. BAZA LIGJORE

III. ARSYETIMI

IV. VENDIMI

A. Në rast miratimi të familjes kujdestare

Miratohet familja: _____
si familje kujdestare për profilin:

- Vullnetar
- Profesional emergjent
- Profesional afatshkurtër
- Profesional afatgjatë
- Profesional terapeutik / të specializuar
- Për vajza nëna me fëmijë

Kapaciteti i miratuar: _____
Grupmosha / profili i fëmijëve: _____

B. Në rast refuzimi të aplikimit

Refuzohet aplikimi i familjes: _____
për këto arsye:

C. Në rast vendosjeje të fëmijës në kujdes alternativ

Vendoset fëmija: _____
në familjen kujdestare: _____
Lloji i kujdesit alternativ: _____
Kohëzgjatja fillestare e vendosjes: _____
Data e fillimit të vendosjes: _____
Kushtet e kontaktit me familjen biologjike:

Afati i rishikimit të parë të rastit: _____

D. Në rast ndryshimi ose përfundimi të vendosjes të fëmijës në kujdes alternativ

Ndryshohet / përfundon vendosja e fëmijës: _____

V. DETYRIMET PËR ZBATIM

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:

- Njësia për mbrojtjen e fëmijës
- Shërbimi social vendor
- Familja kujdestare
- Institucioni arsimor
- Institucioni shëndetësor
- Strukturë tjetër: _____

VI. E DREJTA E ANKIMIT

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit pranë gjykatës administrative _____, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ANËTARËT E KOMISIONIT

Emër, mbiemër; Nënshkrimi

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____